



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJ PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON SUSTAINABLE INVESTMENTS<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O ODRŽIVIM INVESTICIJAMA <sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup>Projektligj për Investime të Qëndrueshme, është aprovuar në mbledhjen e 118 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 02/118, date 11.01.2023.

<sup>2</sup> Draft Law on Sustainable Investments, was approved on the 118 th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.02/118 dated 11.01.2023.

<sup>3</sup> Nacrt Zakona o Održivim Investicijama, usvojen je na 118 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.02/118, datum 11.01.2023.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Mbështetur në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>1. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë promovimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve të qëndrueshme në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 marsit 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian.</p>	<p><b>Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Based on article 65 of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p><b>LAW ON SUSTAINABLE INVESTMENTS</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>1. The purpose of this law is to regulate protection, promotion and encouragement of sustainable investments in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. This Law is in partial compliance with Regulation (EU) 2019/452 of the European Parliament and of the Council of 19 March 2019 establishing a framework for the screening of foreign direct investments into the Union.</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo,</b></p> <p>Na osnovu člana 65 Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O ODRŽIVIM INVESTICIJAMA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>1. Ovaj zakon ima za cilj da reguliše zaštitu, promociju i podsticanje održivih investicija u Republici Kosovo.</p> <p>2. Ovaj zakon je delimično u skladu sa Uredbom (EU) 2019/452 Evropskog Parlamenta i Saveta 19. marta 2019 o uspostavljanju okvira za proveru stranih direktnih investicija unutar Unije.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e institucioneve dhe autoriteteve publike, investitorëve dhe organizatave të tjera lidhur me investimet në Republikën e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>This law shall define the rights and obligations of public institutions and authorities, investors and other organizations related to investments in the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Ovaj zakon definiše prava i obaveze javnih institucija i organa, investitora i drugih organizacija u vezi sa investicijama u Republici Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen.</p> <p>2. <b>Investim</b> nënkupton kapitali që përdoret për të zhvilluar veprimtarinë ekonomike në Republikën e Kosovës, me qëllim të krijimit të të ardhurave dhe fitimit. Investim mund të jetë:</p> <p>2.1. valuta;</p> <p>2.2. e drejta mbi sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm, siç është pronësia, qiraja ose e drejta e ngjashme;</p> <p>2.3. aksioni ose forma tjetër e pjesëmarrjes në shoqëri tregtare;</p> <p>2.4. e drejta e pronësisë intelektuale ose industriale, siç është e drejta e autorit, patenta, marka tregtare, dizajni industrial, e drejta e mbarështuesit, ecuria teknike, njohuria praktike, fshehtësia tregtare, treguesi</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. The terms used in this Law shall have the meaning defined by this Article.</p> <p>2. <b>Investment</b> means the capital used to develop an economic activity in the Republic of Kosovo, for the purpose of generating income and profits. Investments may be:</p> <p>2.1. currency;</p> <p>2.2. the right over movable or immovable property, such as ownership, lease or similar right;</p> <p>2.3. share or other form of participation in a commercial company;</p> <p>2.4. intellectual or industrial property rights, such as copyright, patent, trademark, industrial design, copyright, technical progress, practical know-how, trade secret, geographical indication, trade name or goodwill related to the investment;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju značenja definisana u ovom članu.</p> <p>2. <b>Investicija</b> je kapital koji se koristi za razvoj ekonomske aktivnosti u Republici Kosovo, u cilju stvaranja prihoda i profita. Investicije može biti:</p> <p>2.1. valuta;</p> <p>2.2. pravo na pokretne ili nepokretne stvari, kao što je vlasništvo, zakup ili slično pravo;</p> <p>2.3. akcija ili drugi oblik učešća u privrednom društvu;</p> <p>2.4. pravo intelektualne ili industrijske svojine, kao što su autorsko pravo, patent, žig, industrijski dizajn, pravo oplemenjivača, tehnički napredak, nedokumentovane informacije (<i>know-how</i>), poslovna tajna, geografska oznaka,</p>

<p>gjeografik, emri tregtar ose vullneti i mirë lidhur me investimin;</p> <p>2.5. instrumenti financiar;</p> <p>2.6. leja, licenca ose e drejta tjetër komerciale e përcaktuar me ligj, kontratë ose akt tjetër.</p> <p>3. <b>Investitor</b> nënkupton:</p> <p>3.1. Një person fizik me shtetësi të Republikës së Kosovës ose shtetësi të huaj, që ka për qëllim investimin në Republikën e Kosovës sipas këtij ligji;</p> <p>3.2. Një person juridik ose çdo subjekt i krijuar në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi ose ligjeve të huaja që ka për qëllim investimin në Republikën e Kosovës sipas këtij ligji;</p> <p>4. <b>Investitor i huaj</b> është investitor si vijon:</p> <p>4.1. shtetas i një shteti të huaj;</p> <p>4.2. shtetas i Republikës së Kosovës me vendqëndrim afatgjatë në një vend të huaj;</p> <p>4.3. shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjeve të shtetit të huaj;</p> <p>4.4. shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës në të cilën</p>	<p>2.5. financial instrument;</p> <p>2.6. permit, licence, or other commercial right defined by law, contract or other act.</p> <p>3. <b>Investor</b> means:</p> <p>3.1. A natural person with citizenship of the Republic of Kosovo or foreign citizenship, whose purpose is to invest in the Republic of Kosovo according to this law;</p> <p>3.2. A legal person or any entity created in accordance with the provisions of the law in force or foreign laws that aims to invest in the Republic of Kosovo according to this law;</p> <p>4. <b>Foreign investor</b> is as follows:</p> <p>4.1. national of a foreign state;</p> <p>4.2. citizen of the Republic of Kosova with longterm residence in a foreign country;</p> <p>4.3. business organization established in accordance with the laws of a foreign country;</p> <p>4.4. business organization established under the laws of the Republic of Kosova, where a</p>	<p>poslovno ime ili dobra volja koji se dobro odnosi na investiciju;</p> <p>2.5. finansijski instrument;</p> <p>2.6. dozvola, licenca ili drugo komercijalno pravo definisano zakonom, ugovorom ili drugim aktom.</p> <p>3. <b>Investitor</b> znači:</p> <p>3.1. Fizičko lice sa državljanstvom Republike Kosovo ili stranim državljanstvom, koje ima za cilj da investira u Republici Kosovo u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>3.2. Pravno lice ili bilo koji subjekat osnovan u skladu sa odredbama važećeg zakona ili stranih zakona koje ima za cilj da investira u Republici Kosovo u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>4. <b>Strani investitor</b> je:</p> <p>4.1. državljanin strane zemlje;</p> <p>4.2. državljanin Republike Kosova sa dugotrajnim boravkom u stranoj državi;</p> <p>4.3. trgovačko društvo uspostavljeno na osnovu zakonodavstva strane države;</p> <p>4.4. trgovačko društvo uspostavljeno na osnovu zakonodavstva Republike Kosova,</p>
--	--	---

<p>personi nga nën-paragrafet 4.1-4.3 të këtij neni zotëron shumicën e vendimmarrjes.</p> <p>5. <b>Investim strategjik</b> nënkupton një investim në sektorët prioritar të përcaktuar në këtë ligj, si të një rëndësie të veçantë për ekonominë dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës.</p> <p>6. <b>Investim i qëndrueshëm</b> nënkupton një investim afatgjatë në Republikën e Kosovës në një aktivitet ekonomik që kontribuon në përmirësimin një apo më të objektivave dhe sektorëve prioritar të përcaktuar me këtë ligj, duke i dhënë përparësi përmirësimit të mjedisit, aspektit social, përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes, si dhe potencialit zhvillimor dhe përparësive konkurruese të Republikës së Kosovës.</p> <p>7. <b>Eksportues</b> nënkupton shoqërinë tregtare të identifikuar si eksportues sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, Doganës së Kosovës dhe të regjistruar në regjistrin shtetëror të administruar nga AIE.</p> <p>8. <b>Institucion publik</b> nënkupton organin qendror ose lokal me kompetencë ligjvënëse, ekzekutive, administrative dhe rregullatore në Republikën e Kosovës;</p> <p>9. <b>Valutë lirshëm e konvertueshme</b> nënkupton valutën e lirshëm e konvertueshme</p>	<p>person under paragraphs 4.1.-4.3. owns the majority of decisionmaking.</p> <p>5. <b>Strategic investment</b> means an investment in the priority sectors defined in this law, as of special importance for the economy and development of the Republic of Kosovo.</p> <p>6. <b>Sustainable investment</b> means a long-term investment in the Republic of Kosovo in an economic activity that contributes to the fulfilment of one or more of the objectives and priority sectors defined by this law, giving priority to the improvement of the environment, the social aspect, the improvement of the working environment business, as well as the development potential and competitive advantages of the Republic of Kosovo;</p> <p>7. The Exporter refers to the business organization identified as exporter, according to the data of the Tax Administration of Kosovo, Customs of Kosovo, and registered in the state registry administered by AIE.</p> <p>8. <b>Public institution</b> means a central or local body with legislative, executive, administrative and regulatory competence in the Republic of Kosovo;</p> <p>9. <b>Freely convertible currency</b> means any easily convertible currency designated by the</p>	<p>unutar kojeg osoba predviđena pod 4.1.-4.3. ovog člana ima većinsko odlučivanje.</p> <p>5. <b>Strateška investicija</b> je investicija u prioritetne sektore definisane ovim zakonom, od posebne važnosti za ekonomiju i razvoj Republike Kosova.</p> <p>6. <b>Održiva investicija</b> je dugoročna investicija u Republici Kosovo u privrednu delatnost koja doprinosi ostvarivanju jednog ili više ciljeva i prioritetnih sektora definisanih ovim zakonom, dajući prednost poboljšanju životne sredine, socijalnom aspektu, unapređenje poslovnog okruženja, kao i razvojnom potencijalu i konkurentskim prednostima Republike Kosovo;</p> <p>7. Izvoznik podrazumeva trgovačko društvo identifikovano kao izvozničko, na osnovu podataka Porezne upravne Kosova, Carina Kosova, i registrovano unutar državnog registrara koje vodi AIE.</p> <p>8. <b>Javna institucija</b> je centralni ili lokalni organ sa zakonodavnim, izvršnim, administrativnim i regulatornim nadležnostima u Republici Kosovo;</p> <p>9. <b>Slobodno konvertibilna valuta</b> je slobodno konvertibilna valuta koju definišu Centralna</p>
---	--	--

<p>e përcaktuar nga Banka Qendrore e Kosovës, Banka Qendrore Evropiane ose Fondi Monetar Ndërkombëtar;</p> <p>10. <b>Kontest i investimit</b> nënkupton mosmarrëveshja ose pretendimi lidhur me investimin, që i paraqitet për zgjidhjes përmes ndërmjetësimit, apo Gjykatës Komerciale vendore ose Tribunalit të Arbitrazhit;</p> <p>11. <b>Këshilli</b> nënkupton Këshilli i Investimeve i Republikës së Kosovës;</p> <p>12. <b>Ministria</b> nënkupton ministria përkatëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;</p> <p>13. <b>Ministri</b> nënkupton ministri përkatëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;</p> <p>14. <b>Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AIE)</b> nënkupton, agjensinë për promovimin dhe rritjen e investimeve dhe eksporteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;</p> <p>15. <b>Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (APNK)</b> nënkupton agjensinë për përkrahjen e zhvillimit të NVM-ve, start-up-eve dhe ekosistemeve përkatëse, turizmit dhe zhvillimin e monitorimin e parqeve industriale e teknologjike, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;</p>	<p>Central Bank of Kosovo, the European Central Bank or the International Monetary Fund;</p> <p>10. <b>Investment dispute</b> means the dispute or claim related to the investment, which is submitted for resolution through mediation, to the national Commercial Court or the Arbitration Tribunal.</p> <p>11. <b>Council</b> means the Investment Council of the Republic of Kosovo;</p> <p>12. <b>Ministry</b> means the ministry responsible for industry, entrepreneurship and trade;</p> <p>13. <b>Minister</b> means the minister responsible for industry, entrepreneurship and trade;</p> <p>14. <b>Agencz for Investment and Export (AIE)</b> means the Agency for promotion, increase of investment and exports within the Office of the Prime Minister;</p> <p>15. <b>Agency for Support to the Enterprises in Kosova (ASEK)</b> means the Agency for supporting the development of SMEs, start-ups and relevant ecosystems, export, tourism, and the development and monitoring of industrial and technological parks, within the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade;</p>	<p>banka Kosova, Evropska centralna banka ili Međunarodni monetarni fond;</p> <p>10. <b>Investicioni spor</b> je spor ili tužba u vezi sa investicijom, koja se podnosi na rešavanje medijaciji, državnom Privrednom sudu ili Arbitražnom tribunalu.</p> <p>11. <b>Savet</b> je Investicioni savet Republike Kosovo;</p> <p>12. <b>Ministarstvo</b> je ministarstvo nadležno za industriju, preduzetništvo i trgovinu;</p> <p>13. <b>Ministar</b> je ministar nadležan za poslove industrije, preduzetništva i trgovine;</p> <p>14. <b>Agencija za Investicije i eksport (AIE)</b> je agencija nadležna za promociju, rast investicija i eksporta u okviru Kancelarije premijera;</p> <p>15. <b>Agencija za podršku preduzećima na Kosovu (APPK)</b>, je agencija nadležna za podršku razvoju MSP, start-up i relevantnih ekosistema, izvoza, turizma, kao i razvoj i praćenje industrijskih i tehnoloških parkova, u okviru Ministarstva industrije, preduzetništva i trgovine;</p>
--	--	--

<p>16. <b>Paneli Ankimor</b> nënkupton Paneli Ankimor i Investimeve i Republikës së Kosovës;</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Parimet themelore</b></p> <p>1.Republika e Kosovës nxit dhe mbron investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me këto instrumente:</p> <p>1.1. Parimet e investimit të përgjegjshëm, të mbështetura nga Kombet e Bashkuara; Rezolutën 71/313 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara;</p> <p>1.2.Deklarata dhe vendimet për investimet ndërkombëtare dhe ndërmarrjet shumëkombëshe të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).</p> <p><b>KAPITULLI II TË DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5 E drejta e investimit</b></p> <p>Çdonjëri ka të drejtë të investojë në çdo lloj të veprimtarisë ekonomike dhe në çdo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>16.<b>Complaints Panel</b> means the Investment Complaints Panel of the Republic of Kosovo;</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 Basic principles</b></p> <p>1.The Republic of Kosovo shall promote and protect responsible and sustainable investments, in line with the following instruments:</p> <p>1.1. Principles for Responsible Investment, supported by the United Nations; Resolution 71/313 of the United Nations General Assembly;</p> <p>1.2. Declaration and Decisions on International Investment and Multinational Enterprises of the Organization for Economic Co-operation and Development (OECD).</p> <p><b>CHAPTER II RIGHTS AND OBLIGATIONS OF INVESTORS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5 Right to invest</b></p> <p>Everyone shall have the right to invest in any kind of economic activity and in any part of the territory of the Republic of Kosovo in accordance with the legislation in force.</p>	<p>16. <b>Žalbeno veće</b> je Žalbeno veće za investicije Republike Kosovo;</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4 Osnovni principi</b></p> <p>1.Republika Kosovo podstiče i štiti odgovorne i održive investicije, u skladu sa ovim instrumentima:</p> <p>1.1. Principi odgovornog investiranja, podržani od Ujedinjenih nacija; Rezolucija - 71/313 Generalne skupštine Ujedinjenih nacija;</p> <p>1.2. Deklaracija i odluke o međunarodnim investicijama i multinacionalnim preduzećima Organizacije za ekonomsku saradnju i razvoj (OECD).</p> <p><b>POGLAVLJE II PRAVA I OBAVEZE INVESTITORA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5 Pravo na investicije</b></p> <p>Svako ima pravo da investira u bilo koju vrstu privredne delatnosti i u bilo kom delu teritorije Republike Kosovo u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
---	---	--

<p align="center"><b>Neni 6</b> <b>Barazia para ligjit</b></p>	<p align="center"><b>Article 6</b> <b>Equality before the law</b></p>	<p align="center"><b>Član 6</b> <b>Jednakost pred zakonom</b></p>
<p>1. Të gjithë investitorët dhe investimet e tyre janë të barabartë para ligjit.</p> <p>2. Ndalohet diskriminimi ndaj investitorit për shkak të kombësisë ose lidhjes me ndonjë komunitet, prejardhjes shoqërore ose kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike, vendbanimit, vendit të themelimit ose vendit të kontrollit.</p> <p>3. Investitori i huaj ka të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore sikurse investitori vendor.</p> <p>4. Investitori i nënshtrohet detyrimit të pajtueshmërisë me ligjin sipas nenit 9 të këtij ligji.</p> <p>5. Investitori mund të gëzojë përfitim ose përparësi të posaçme sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, sidomos lidhur me:</p> <p>5.1. mënyrën e zgjidhjes së kontestit të investimeve;</p>	<p>1. All investors and their investments shall be equal before the law.</p> <p>2. Discrimination against the investor due to nationality or affiliation with any community, social or national origin, race, ethnicity, colour, gender, gender identity, sexual orientation, language, citizenship, health status, limited ability, genetic inheritance, place of residence, place of establishment or place of control shall be prohibited.</p> <p>3. The foreign investor shall have the same rights and legal obligations as the domestic investor.</p> <p>4. The investor shall be subject to the obligation to comply with the law according to Article 9 of this law.</p> <p>5. The investor may enjoy special benefits or advantages according to international agreements, especially with regards to:</p> <p>5.1. method of resolving investment disputes;</p>	<p>1. Svi investitori i njihove investicije jednaki su pred zakonom.</p> <p>2. Zabranjena je diskriminacija investitora zbog nacionalnosti ili pripadnosti bilo kojoj zajednici, društvenog ili nacionalnog porekla, rase, etničke pripadnosti, boje kože, pola, rodnog identiteta, seksualne orijentacije, - jezika, državljanstva, zdravstvenog stanja, ograničene sposobnosti, genetskog nasleđa, prebivališta, mesta osnivanja ili mesta kontrole.</p> <p>3. Strani investitor ima ista prava i zakonske obaveze kao i domaći investitor.</p> <p>4. Investitor podleže obavezi usklađenosti sa zakonom prema članu 9. ovog zakona.</p> <p>5. Investitor može uživati pogodnosti ili - poseban prioritet prema međunarodnim ugovorima, posebno u vezi sa:</p> <p>5.1. načinom rešavanja investicionog spora</p>



<p>5.2. bashkimin doganor, ekonomik ose monetar, tregun e përbashkët, hapësirën e tregtisë së lirë ose organizatat ekonomike rajonale dhe ndërkombëtare;</p> <p>5.3. shmangien e tatimit të dyfishtë ose çështje tjetër të tatimit.</p>	<p>5.2. customs, economic or monetary union, common market, free trade area or regional and international economic organizations;</p> <p>5.3. avoidance of double taxation or other tax issues.</p>	<p>5.2. carinskom, ekonomskom ili monetarnom unijom, zajedničkim tržištem, zonom slobodne trgovine ili regionalnim i međunarodnim ekonomskim organizacijama;</p> <p>5.3. izbegavanje dvostrukog oporezivanja ili drugog oporezivanja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Mbrojtja dhe siguria</b></p> <p>1. Investitori dhe investimet gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Mbrojtja dhe siguria e investitorëve dhe investimeve nuk mund të jenë më pak të favorshme se ç'kërkohet me këtë ligj ose me normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Protection and security</b></p> <p>1. The investor and investments shall enjoy complete and continuous protection and security in compliance with the legislation in force in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The protection and security of the investors and investments shall not be less favourable than it is required by this law or the generally accepted norms of the international law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Zaštita i bezbednost</b></p> <p>1. Investitor i investicije uživaju punu i kontinuiranu zaštitu i bezbednost u skladu sa važećim zakonodavstvom u Republici Kosovo.</p> <p>2. Zaštita i bezbednost investitora i investicija ne može biti nepovoljnija od onoga što je propisano ovim zakonom ili opšteprihvaćenim normama međunarodnog prava.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Respektimi i të drejtave</b></p> <p>1. Institucionet publike duhet:</p> <p>1.1. të veprojnë brenda autorizimeve të veta ligjore kundrejt investitorit;</p> <p>1.2. të njohin dhe të respektojnë të drejtat e investitorit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Respect of rights</b></p> <p>1. Public institutions shall:</p> <p>1.1. act within their legal authorizations vis-à-vis the investor;</p> <p>1.2. recognize and respect the investor rights defined by the legislation in force,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Poštovanje prava</b></p> <p>1. Javne institucije treba:</p> <p>1.1. da postupaju u okviru svojih zakonskih ovlašćenja prema investitoru;</p> <p>1.2. da priznaju i poštuju prava investitora definisana u skladu sa važećim zakonodavstvom,</p>

<p>1.3. të zhvillojë procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke vepruar sidomos në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me parimet e tjera procedurale;</p> <p>1.4. t'i japë investitorit mundësi të arsyeshme për të paraqitur fakte dhe argumente në procedurën administrative, për sa lejojnë natyra e procedurës dhe interesi publik;</p> <p>1.5. të mundësojë ushtrimin e mjeteve juridike sipas Kushtetutës dhe ligjit.</p> <p>2. E drejta nga ky ligj mund të kufizohet në rast se cenohet rendi publik, morali, siguria shtetërore, shëndeti publik, mjedisi dhe legjislacioni në fuqi.</p>	<p>1.3. develop the procedure in accordance with the legislation in force, by acting in particular in accordance with the principle of proportionality and other procedural principles;</p> <p>1.4. provide reasonable opportunity to the investor to present facts and arguments in the administrative procedure, to the extent allowed by the nature of procedure and public interest;</p> <p>1.5. enable the exercise of legal remedies according to the Constitution and the law.</p> <p>2. The right emerging from this law may be limited in cases when public order, morality, national security, public health, environment and legislation in force are violated.</p>	<p>1.3. da razviju postupak u skladu sa - važećim zakonodavstvom, postupajući posebno u skladu sa načelom proporcionalnosti i drugim proceduralnim načelima;</p> <p>1.4. dati investitoru razumne mogućnosti da u upravnom postupku iznese činjenice i argumente, u meri u kojoj priroda postupka i javni interes dozvoljavaju;</p> <p>1.5. omogućće korišćenje pravnih lekova u skladu sa Ustavom i zakonom.</p> <p>2. Pravo iz ovog zakona može se ograničiti u slučaju kršenja javnog reda, morala, državne sigurnosti, javnog zdravlja, životne sredine i važećih zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Pajtueshmëria me ligjin</b></p> <p>1. Investitori i nënshtrohet legjislacionit vendor dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës.</p> <p>2. Investitori duhet të respektojë sidomos:</p> <p>2.1. legjislacionin për punën, shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Compliance with the law</b></p> <p>1. The investor shall be subject to domestic legislation and international agreements ratified by the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The investor shall respect in particular:</p> <p>2.1. legislation on labour, health, security and environment;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Usklađenost sa zakonom</b></p> <p>1. Investitor podleže domaćem zakonodavstvom i međunarodnim sporazumima ratifikovanim od strane Republike Kosovo.</p> <p>2. Investitor treba da poštuje posebno :</p> <p>2.1. zakonodavstvo o radu, zdravlju, bezbednosti i životnoj sredini;</p>

<p>2.2.parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit;</p> <p>2.3.parimet e trajtimit të barabartë dhe rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndihmës shtetërore;</p> <p>2.4.detyrimet përkatëse për sigurimin nga përgjegjësia;</p> <p>2.5.detyrimin për regjistrimin e pronarëve përfitues dhe legjislacionin kundër shpëlarjes së parasë, investimeve ofshore dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>2.6.legjislacionin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare;</p> <p>2.7. detyrimet e Republikës së Kosovës nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian;</p> <p>3. Investitori ose investimi mund t'i nënshtrohet verifikimit plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji.</p> <p>4. Institucioni publik mund t'i kërkojë investitorit kompensim për dëmin e shkaktuar nga shkelja e këtij ligji ose aktit tjetër. Kompensimi caktohet sipas nenit 14 të këtij ligji.</p>	<p>2.2. principles of free movement of goods, services and capital;</p> <p>2.3. principles of equal treatment and rules of free competition and state aid;</p> <p>2.4. relevant liability insurance obligations;</p> <p>2.5. the obligation to register beneficial owners and legislation against money laundering, offshore investments and terrorist financing;</p> <p>2.6. legislation on the implementation of international sanctions;</p> <p>2.7. obligations of the Republic of Kosovo from the Stabilisation and Association Agreement with the European Union;</p> <p>3. The investor or investment may be subject to screening in accordance with Chapter VII of this Law.</p> <p>4. The public institution may ask the investor for compensation of the damage caused by the violation of this law or another act. Compensation is determined according to Article 14 of this law.</p>	<p>2.2. principe slobodnog kretanja roba, usluga i kapitala;</p> <p>2.3. principe jednakog tretmana i pravila slobodne konkurencije i državne pomoći;</p> <p>2.4. odgovarajuće obaveze za osiguranje od odgovornosti;</p> <p>2.5. obaveza registracije stvarnih vlasnika i zakonodavstvo protiv pranja novca, offshore investicija i finansiranja terorizma;</p> <p>2.6. zakonodavstvo za sprovođenje međunarodnih sankcija;</p> <p>2.7. obaveze Republike Kosovo iz Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju sa Evropskom unijom</p> <p>3. Investitor ili investicija može biti predmet dodatne provere u skladu sa Poglavljem VII ovog zakona.</p> <p>4. Javna institucija može tražiti od investitora naknadu štete prouzrokovane kršenjem ovog zakona ili drugog akta. Naknada se utvrđuje u skladu sa članom 14. ovog zakona.</p>
---	---	---

<p>5. Institucioni publik mund t'i shqiptojë investitorit sanksion për shkelje të ligjit ose aktit tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Mbrojtja nga shpronësimi</b></p> <p>1. Investimi nuk mund të shpronësohet ose të shtetëzohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, përveçse kur është e domosdoshme për qëllimin ose interesin publik, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për shpronësim.</p> <p>2. Nuk përbën shpronësim ose shtetëzim zbatim i legjislacionit të përgjithshëm.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Konvertimi i valutës dhe transferimet</b></p> <p>1. Për çdo pagesë, detyrim ose fitim që ka të bëjë me shoqëri investuese ose investim në Republikën e Kosovës, investitori mund të konvertetohet:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. valutën e ligjshme vendore në valutë lirshëm të konvertueshme;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. valutën lirshëm të konvertueshme në valutë të ligjshme vendore.</p>	<p>5. The public institution may impose a sanction on the investor for violation of the law or other act, in accordance with the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Protection from expropriation</b></p> <p>1. The investment may not be expropriated or nationalized directly or indirectly, except when it is necessary for the purpose or public interest, according to the legal provisions of the Law on Expropriation.</p> <p>2. The implementation of general legislation does not constitute expropriation or nationalization.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Currency conversion and transfers</b></p> <p>1. For any payment, obligation or profit related to the investment company or investment in the Republic of Kosovo, the investor may convert:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. legal local currency into freely convertible currency;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. freely convertible currency into a legal local currency.</p>	<p>5. Javna institucija može izreći sankciju investitoru za kršenje zakona ili drugog akta, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Zaštita od eksproprijacije</b></p> <p>1. Investicija se ne može eksproprijisati ili nacionalizovati direktno ili indirektno, osim kada je to neophodno u svrhu ili za javni interes, u skladu sa zakonskim odredbama Zakona o eksproprijaciji.</p> <p>2. Sprovođenje opšteg zakonodavstva ne predstavlja eksproprijaciju ili nacionalizaciju.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Konverzija i transferi valuta</b></p> <p>1. Za bilo koje plaćanje, obavezu ili dobit u vezi sa investicionim društvom ili investicijom u Republici Kosovo, investitor može konvertovati:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. legalnu domaću valutu u slobodno - konvertibilnoj valuti;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. slobodno konvertibilnu valutu u legalnu domaću valutu.</p>
--	---	---

<p>2. Investitori mund të transferojë paratë në valutë të konvertueshme brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Investitori mund të konvertojë ose të transferojë valutën sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij neni kurdo që e çmon të nevojshme:</p> <p>3.1. për të rritur kapitalin e deklaruar ose operues të shoqërisë investuese ose të investimit tjetër në Republikën e Kosovës;</p> <p>3.2. për të ruajtur, për të riatdhësuar ose për të disponuar në tjetër mënyrë kthimet, fitimet, pagesat ose të ardhurat e pranura lidhur me shoqërinë investuese ose investimin tjetër në Republikën e Kosovës;</p> <p>3.3. për të bërë pagesë sipas kontratës;</p> <p>3.4. për të ruajtur, për të riatdhësuar ose për të disponuar në tjetër mënyrë të ardhurat nga tjetërsimi i kontrollit të shoqërisë investuese ose investimit tjetër në Republikën e Kosovës;</p> <p>3.5. për të ruajtur, për të riatdhësuar ose për të disponuar në tjetër mënyrë pagesën e pranuar si kompensim nga zgjidhja e kontestit ose si rrjedhojë e zbatimit të këtij ligjit.</p> <p>4. Konvertimi ose transferimi i paratë kryhet pa vonesë në përputhje me ligjin përkatës për sistemin e pagesave, ligjin për parandalimin e</p>	<p>2. The investor may transfer cash into a convertible currency in the Republic of Kosovo and abroad.</p> <p>3. The investor may convert or transfer currency as referred to in paragraphs 1 or 2 of this Article whenever he deems necessary:</p> <p>3.1. to increase the declared or operating capital of the investment company or other investment in the Republic of Kosovo;</p> <p>3.2. to retain, repatriate or otherwise dispose of returns, profits, payments or income received in connection with the investment company or other investment in the Republic of Kosovo;</p> <p>3.3. to make a payment under the contract;</p> <p>3.4. to retain, repatriate or otherwise dispose of the proceeds from the alienation of control of the investment company or other investment in the Republic of Kosovo;</p> <p>3.5. to retain, repatriate or otherwise dispose of the payment received as compensation from the settlement of a dispute or as a result of the implementation of this Law.</p> <p>4. The conversion (exchange) or transfer of money shall be carried out without delay in accordance with the relevant law on the</p>	<p>2. Investitor može da prenosi novac u konvertibilnoj valuti unutar i van Republike Kosovo.</p> <p>3. Investitor može konvertovati ili preneti - valutu iz st. 1. ili 2. ovog člana kad god smatra da je to potrebno:</p> <p>3.1. da poveća deklarisanu ili operativnu kapital investicionog društva ili druge investicije u Republici Kosovo;</p> <p>3.2. da zadrži, repatrira ili na drugi način raspolaže povraćajima, dobitima, isplatom ili prihodima primljenim u vezi sa investicionim društvom ili drugom investicijom u Republici Kosovo;</p> <p>3.3. da izvrši plaćanje prema ugovoru;</p> <p>3.4. da zadrži, repatrira ili na drugi način raspolaže prihodima od otuđenja kontrole investicionog društva ili druge investicije u Republici Kosovo;</p> <p>3.5. da zadrži, repatrira ili na drugi način raspolaže uplatom primljenom kao kompenzacijom iz rešenja spora ili kao rezultat primene ovog zakona.</p> <p>4. Konverzija (razmena) ili transfer novca se vrši bez odlaganja u skladu sa relevantnim zakonom o platnom prometu, zakonom o</p>
---	---	--

<p>shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>5. Konvertimi bëhet sipas kursit të këmbimit në treg.</p> <p>6. E drejta nga ky nen mund të kushtëzohet me përmbushjen e detyrimeve ndaj autoritetit publik ose të kufizohet në mënyrë tjetër sipas paragrafit 2 të nenit 8 të këtij ligji.</p>	<p>payment system, the law on the prevention of money laundering and terrorist financing and other legislation in force.</p> <p>5. Conversion shall be made at a market rate of exchange.</p> <p>6. The right from this article may be subject to the fulfilment of obligations to the public authority or otherwise limited according to paragraph 2 of Article 8 of this law.</p>	<p>spreçavanju pranja novca i finansiranja terorizma i drugim važećim zakonima.</p> <p>5. Konverzija se vrši prema tržišnom kursu.</p> <p>6. Pravo iz ovog člana može biti uslovljeno ispunjenjem obaveza prema javnom autoritetu ili biti ograničeno na drugi način prema stavu 2 člana 8 ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Tjetërsimi i investimit</b></p> <p>1. Investitori mund të tjetërsojë investimin ose të ndërpresë veprimtarinë ekonomike sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Investitori mund të riatdhesojë sendet jomonetare të fituara nga tjetërsimi i investimit.</p> <p>3. Investitori mund të konvertojë dhe të transferojë sipas nenit 11 të këtij ligji paratë e fituara nga tjetërsimi i investimit.</p> <p>4. E drejta nga ky nen mund të kushtëzohet me përmbushjen e detyrimeve ndaj autoritetit publik ose të kufizohet në mënyrë tjetër sipas paragrafit 2 të nenit 8 të këtij ligji.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Liquidation of an investment</b></p> <p>1. An investor may liquidate an investment or terminate the economic activity, in accordance with the legislation in force.</p> <p>2. An investor may repatriate non-monetary assets received as a result of the liquidation of investment.</p> <p>3. The investor may convert and transfer the money received as a result of the liquidation of investment in accordance with Article 11 of this Law.</p> <p>4. The right from this Article may be subject to the fulfilment of obligations to the public authority or be otherwise limited in accordance with paragraph 2 of Article 8 of this Law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Otuđenje investicija</b></p> <p>1. Investitor može otuđiti investiciju ili zaustaviti privrednu delatnost u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Investitor može da vrati nenovčane stvari stečene otuđenjem investicije.</p> <p>3. Investitor može konvertovati i preneti u skladu sa članom 11. ovog zakona novac zarađen otuđenjem investicije.</p> <p>4. Pravo iz ovog člana može biti uslovljeno ispunjenjem obaveza prema javnom autoritetu ili biti ograničeno na drugi način prema stavu 2 člana 8 ovog zakona.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Kompensimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Compensation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Naknada</b></p>
<p>1. Kompensimi për shpronësim ose shtetëzim lidhur me investimet:</p> <p>1.1. caktohet sipas vlerës që sendi ka pasur në treg para shpronësimit ose shtetëzimit, me kusht që vlera të mos jetë ndikuar nga:</p> <p>1.1.1. shpronësimi ose shtetëzimi; ose</p> <p>1.1.2. dijenia ose parashikimi i shpronësimit ose shtetëzimit;</p> <p>1.2. përfshin kamatën e barabartë me normën gjerësisht të pranueshme në vendet e Bashkimit Evropian, që zbatohet nga data e shpronësimit ose shtetëzimit deri kur të paguhet i gjithë kompensimi.</p> <p>2. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj të posaçëm në fuqi, kompensimi nga ky nen nuk përfshin kompensimin e fitimit të humbur ose kompensimin e kostos së zbatimit të legjislacionit të ri.</p> <p>3. E drejta nga ky nen mund të kushtëzohet me përmbushjen e detyrimeve ndaj autoritetit publik ose të kufizohet në mënyrë tjetër sipas paragrafit 2 të nenit 8 të këtij ligji.</p>	<p>1. Compensation for expropriation or nationalization related to investments:</p> <p>1.1. shall be determined according to the value of the asset in the market before expropriation or nationalization, provided the value is not influenced by:</p> <p>1.1.1. expropriation or nationalization; or</p> <p>1.1.2. awareness or provision of expropriation or nationalization;</p> <p>1.2. shall include the interest equal to the generally accepted rate in the European Union member states, which is applied from the date of expropriation or nationalization until all compensation is paid.</p> <p>2. Unless otherwise provided by a special applicable law, compensation from this Article shall not include compensation for the lost profit or compensation for the cost of implementation of the new legislation.</p> <p>3. The right from this Article may be subject to the fulfilment of obligations to the public authority or otherwise limited according to paragraph 2 of Article 8 of this Law.</p>	<p>1. Naknada za eksproprijaciju ili nacionalizaciju u vezi sa investicijama:</p> <p>1.1. utvrđuje se prema vrednosti koju je stvar imala na tržištu pre eksproprijacije ili nacionalizacije, pod uslovom da na vrednost nije uticala:</p> <p>1.1.1. eksproprijacija ili nacionalizacija; ili;</p> <p>1.1.2. znanje ili predviđanje - eksproprijacije ili nacionalizacije;</p> <p>1.2. uključuje kamatu jednaku široko prihvaćenoj stopi u zemljama Evropske unije, koja se primenjuje od datuma eksproprijacije ili nacionalizacije do isplate celokupne naknade</p> <p>2. Ako posebnim važećim zakonom nije drugačije određeno, naknada iz ovog člana ne uključuje naknadu za izgubljenu dobit ili naknadu troškova sprovođenja novog zakonodavstva.</p> <p>3. Pravo iz ovog člana može biti uslovljeno ispunjenjem obaveza prema javnom organu ili biti ograničeno na drugi način prema stavu 2. člana 8. ovog zakona.</p>

<p>4. Institucioni publik dhe investitori nuk përjashtohen nga kërkesa për kompensim.</p> <p><b>KAPITULLI III PRIORITETET DHE LEHTËSIRAT</b></p> <p><b>Neni 14 Objektivat shtetërorë</b></p> <p>1. Objektiva shtetërorë që Republika e Kosovës synon t'i përmbushë përmes nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve janë:</p> <p>1.1. prodhimi dhe eksporti;</p> <p>1.2. rritja e konkurrueshmërisë së industrisë vendore;</p> <p>1.3. zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë;</p> <p>1.4 fuqizimi i ekosistemit industrial</p> <p>1.5. aftësimi dhe punësimi i fuqisë punëtore;</p> <p>1.6. fuqizimi i rinisë, gruas, komuniteteve jo shumicë dhe grupeve të marginalizuara;</p> <p>1.7. qëndrueshmëria e lëvizjes së popullsisë;</p> <p>1.8. angazhimi i diasporës;</p> <p>1.9. zhvillimi rajonal;</p>	<p>4. The public institution and the investor shall not be precluded from requests for compensation.</p> <p><b>CHAPTER III PRIORITIES AND FACILITATION</b></p> <p><b>Article 14 National objectives</b></p> <p>1. State objectives that Republic of Kosovo intends to fulfill through promotion and protection of investments are:</p> <p>1.1. manufacturing and exports;</p> <p>1.2. increase competitiveness of domestic industry;</p> <p>1.3. develop innovation and technology;</p> <p>1.4 enhance the industrial ecosystem;</p> <p>1.5. train and employ the work force;</p> <p>1.6. empower youth, women, non-majority communities and marginalized groups;</p> <p>1.7. sustainability of the movement of people;</p> <p>1.8. engagement of diaspora;</p> <p>1.9. regional development;</p>	<p>4. Javna institucija i investitor su izuzeti od zahteva za nadoknadom.</p> <p><b>POGLAVLJE III PRIORITETI I OLAKŠICE</b></p> <p><b>Član 14 Državni ciljevi</b></p> <p>1. Državni ciljevi koje Republika Kosovo nastoji da ispuni kroz podsticanje i zaštitu investicija su:</p> <p>1.1. proizvodnja i izvoz;</p> <p>1.2. povećanje konkurentnosti lokalne industrije;</p> <p>1.3. razvoj inovacija i tehnologije;</p> <p>1.4 jačanje industrijskog ekosistema</p> <p>1.5. obuka i zapošljavanje radne snage;</p> <p>1.6. osnaživanje mladih, žena i nevećinskih zajednica i marginalizovanih grupa;</p> <p>1.7. održivost kretanja stanovništva;</p> <p>1.8. angažman dijaspore;</p> <p>1.9. regionalni razvoj;</p>
---	---	--



<p>2.4.2.Përgatitja dhe vlerësimi i studimeve të fizibilitetit dhe masterplaneve për zhvillimin e zonave;</p> <p>24.3.Selektimi i operatorëve ekonomik për zhvillimin dhe ndërtimin e zonave;</p> <p>2.4.4.Shpërndarja e resurseve në parqet industriale dhe teknologjike;</p> <p>2.4.5.Pjesëmarrja në proceset e funksionalizimit të parqeve industriale dhe dhe shfrytëzimit të tokës;</p> <p>2.4.6.Projektimi dhe sigurimi i infrastrukturës në parqet industriale dhe teknologjike;</p> <p>2.4.7.Sigurimi i koordinimit të ngushtë me komunat për zhvillimin dhe funksionimin e parqeve industriale dhe teknologjike;</p> <p>2.4.8.Bashkëpunimi, pranimi, shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve të ofruara nga komunat e Kosovës për themelimin dhe ndërtimin e parqeve industriale dhe teknologjike si dhe bashkëpunimi për vendosjen e investitorëve brenda këtyre parqeve;</p> <p>2.4.9.Sigurimi i investitorëve me informacion mbi karakteristikat specifike;</p>	<p>2.4.2. Preparation and evaluation of feasibility studies and master plans for the development of areas;</p> <p>24.3. Selection of economic operators for the development and construction of areas;</p> <p>2.4.4. Distribution of resources in industrial and technological parks;</p> <p>2.4.5. Participation in the functionalization processes of industrial parks and land use;</p> <p>2.4.6. Design and provision of infrastructure in industrial and technological parks;</p> <p>2.4.7. Ensuring close coordination with municipalities for the development and operation of industrial and technological parks;</p> <p>2.4.8. Cooperation, acceptance, review and evaluation of applications provided by the municipalities of Kosovo for the establishment and construction of industrial and technological parks, as well as cooperation for the placement of investors within these parks;</p> <p>2.4.9. Providing investors with information on specific characteristics;</p>	<p>2.4.2. Izrada i evaluacija studija izvodljivosti i master planova razvoja područja;</p> <p>24.3. Izbor ekonomskih operatera za razvoj i izgradnju područja;</p> <p>2.4.4. Raspodela resursa u industrijskim i tehnološkim parkovima;</p> <p>2.4.5. Učešće u procesima funkcionalizacije industrijskih parkova i korišćenja zemljišta;</p> <p>2.4.6. Projektovanje i obezbeđenje infrastrukture u industrijskim i tehnološkim parkovima;</p> <p>2.4.7. Obezbeđivanje bliske saradnje sa opštinama za razvoj i rad industrijskih i tehnoloških parkova;</p> <p>2.4.8. Saradnja, prihvatanje, razmatranje i ocenjivanje aplikacija opština Kosova za osnivanje i izgradnju industrijskih i tehnoloških parkova, kao i saradnja za postavljanje investitora u okviru ovih parkova;</p> <p>2.4.9. Pružanje informacija investitorima o specifičnim karakteristikama;</p>
---	---	--



<p>2.4.10.Ndihma e investitorëve për regjistrim në parqet e caktuara industriale dhe teknologjike dhe proceset administrative.</p> <p>2.5.Lidhur me parqet industriale dhe teknologjike, APNK:</p> <p>2.5.1.Shqyrton kërkesat për themelim të parkut industrial dhe teknologjik;</p> <p>2.5.2.Administron parkun industrial dhe teknologjik se bashku me themeluesin, përveç ne rastet kur komuna ose shoqëria tregtare financon vete ndërtimin dhe funksionalizimin e tij;</p> <p>2.5.3.Kryen shërbimet e Sekretarisë për administruesin e parkut industrial dhe teknologjik;</p> <p>2.5.4.Mban regjistër publik për parqet industriale dhe teknologjike dhe inkubatorët e biznesit, dhe ia vendosë në dispozicion institucioneve publike qeveritare, palëve të interesit dhe organizatave.</p> <p>3. Qeveria me akte nënligjore përcakton përbërjen e APNK si dhe funksionet e saj.</p>	<p>2.4.10. Assistance to investors for registration in certain industrial and technological parks and administrative processes.</p> <p>2.5. Regarding industrial and technological parks, APNK shall:</p> <p>2.5.1. Examine the requirements for the establishment of the industrial and technological park;</p> <p>2.5.2. Administer the industrial and technological park together with the founder, except in cases where the municipality or commercial company finances its construction and operation;</p> <p>2.5.3. Performs Secretariat services for the administrator of the industrial and technological park;</p> <p>2.5.4. Keeps a public register for industrial and technological parks and business incubators, and makes it available to public government institutions, stakeholders and organizations.</p> <p>3. The government determines the composition of APNK as well as its functions by means of by-laws.</p>	<p>2.4.10. Pomoć investitorima za registraciju u pojedinim industrijskim i tehnološkim parkovima i administrativnim procesima.</p> <p>2.5. U pogledu industrijskih i tehnoloških parkova, APNK će:</p> <p>2.5.1. Ispitati uslove za osnivanje industrijskog i tehnološkog parka;</p> <p>2.5.2. Industrijsko-tehnološkim parkom upravlja zajedno sa osnivačem, osim u slučajevima kada opština ili privredno društvo finansira njegovu izgradnju i rad;</p> <p>2.5.3. Obavlja poslove Sekretarijata za administratora industrijskog i tehnološkog parka;</p> <p>2.5.4. Vodi javni registar za industrijske i tehnološke parkove i poslovne inkubatore i stavlja ga na raspolaganje državnim institucijama, zainteresovanim stranama i organizacijama.</p> <p>3. Vlada podzakonskim aktom utvrđuje sastav APNK i njegove funkcije.</p>
---	--	--

<b>Neni 21 Këshilli</b>	<b>Article 21 Council</b>	<b>Član 21 Savet</b>
<p>1. Këshilli i Investimeve në Republikën e Kosovës bënë vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vendos për projektet për investime strategjike në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji.</p> <p>2. Këshilli përbëhet nga:</p> <p>2.1. Kryeministri, kryesues;</p> <p>2.2. Ministri përgjegjës për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë, zëvendëskryesues;</p> <p>2.3. Ministri përgjegjës për financat;</p> <p>2.4. Ministri përgjegjës për mjedisin, planifikimin hapësinor dhe infrastrukturën;</p> <p>2.5. Ministri përgjegjës për ekonomi;</p> <p>2.6. Ministri përgjegjës për bujqësi;</p> <p>2.7. Ministri përgjegjës për qeverisje lokale;</p> <p>2.8. Anëtarë të tjerë të caktuar me vendim të Qeverisë.</p> <p>3. Qeveria me vendim mund të shtojë numrin e anëtarëve të Këshillit sipas nevojës.</p>	<p>1. The Investment Council of the Republic of Kosovo shall evaluate, select, implement, supervise and decide on strategic investment projects in accordance with the legal provisions of this law.</p> <p>2. The Council shall consist of:</p> <p>2.1. Prime Minister, Chair;</p> <p>2.2. Minister responsible of industry, entrepreneurship and trade, deputy chair;</p> <p>2.3. Minister responsible of finance;</p> <p>2.4. Minister responsible of environment, spatial planning and infrastructure;</p> <p>2.5. Minister responsible of economy;</p> <p>2.6. Minister responsible of agriculture;</p> <p>2.7; Minister responsible for local governance;</p> <p>2.8. Other members as determined by the decision of the Government.</p> <p>3. The Government can add the number of the members of the Council as per need.</p>	<p>1. Investicioni Savet Republike Kosovo ocenjuje, bira, sprovodi, nadgleda i odlučuje o strateškim investicionim projektima u skladu sa zakonskim odredbama ovog zakona.</p> <p>2. Savet se sastoji od:</p> <p>2.1. Premijer, predsedavajući;</p> <p>2.2. Ministar nadležan za poslove industrije, preduzetništva i trgovine, zamenik predsedavajućeg;</p> <p>2.3. Ministar nadležan za finansije;</p> <p>2.4. Ministar nadležan za životnu sredinu, - prostorno planiranje i infrastrukturu;</p> <p>2.5. Ministar nadležan za ekonomiju;</p> <p>2.6. Ministar nadležan za poljoprivredu;</p> <p>2.7. Ministar nadležan za lokalnu samoupravu;</p> <p>2.8. ostali članovi predviđeni odlukom Vlade.</p> <p>3. Vlada može odlukom dodati broj članova Saveta prema potrebi.</p>

<p>4. Këshilli bart këto përgjegjësi:</p> <p>4.1. miraton plane veprimi dhe raporte për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke u kushtuar vëmendje mënjanimin të barrierave për investimet, përmirësimin të mjedisit të veprimtarisë ekonomike, mundësive zhvillimore dhe përparësive krahasuese të Republikës së Kosovës;</p> <p>4.2. nxjerr vendime për investimet strategjike sipas nenit 36 të këtij ligji;</p> <p>4.3. publikon ftesa dhe negocion marrëveshje lidhur me investimet strategjike sipas neneve 29 dhe 35 të këtij ligji;</p> <p>4.4. përcakton masat, procedurat, afatet dhe detyrimet e autoriteteve publike lidhur me hartimin dhe zbatimin e projekteve të investimit strategjik;</p> <p>4.5. mbikëqyr zbatimin e investimeve strategjike;</p> <p>4.6. kërkon verifikim plotësues të investimeve dhe nxjerr vendime mbi vlerësimin plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji.</p>	<p>4. The Council shall have the following responsibilities:</p> <p>4.1. approve action plans and publish reports on the promotion and protection of investments, paying attention to the identification of interests, improving the environment of economic activity, development opportunities and comparative advantages of the Republic of Kosovo;</p> <p>4.2. issue decisions on strategic investments as defined by Article 36 of this Law;</p> <p>4.3 publish invitations and negotiate agreements concluded with strategic investments as defined by Articles 29 and 35 of this Law;</p> <p>4.4. define measures, procedures, terms and obligations of the public authorities related to the design and implementation of strategic investment projects;</p> <p>4.5. oversee the implementation of strategic investments;</p> <p>4.6. request screening of investments and issue decisions on screening as defined by Chapter VII of this Law.</p>	<p>4. Savet ima sledeće odgovornosti:</p> <p>4.1. usvaja akcione planove i objavljuje izveštaje za promociju i zaštitu investicija, obraćajući pažnju na uklanjanje barijera, poboljšanje ambijenta ekonomske aktivnosti, razvojne mogućnosti i komparativne prednosti Republike Kosovo;</p> <p>4.2. donosi odluke o strateškim investicijama u skladu sa članom 36. ovog zakona;</p> <p>4.3. objavljuje pozive i pregovara o - ugovorima koji se odnose na strateške investicije u skladu sa članovima 29. i 35. ovog zakona;</p> <p>4.4. utvrđuje mere, postupke, rokove i obaveze organa javne vlasti u vezi sa osmišljavanjem i realizacijom strateških investicionih projekata;</p> <p>4.5. vrši nadzor nad sprovođenjem - strateških investicija;</p> <p>4.6. zahteva dodatnu proveru investicija i donosi odluke o dodatnoj proveri u skladu sa Poglavljem VII ovog zakona.</p>
---	--	--

<p>4.7. Kryen funksione të tjera lidhur me fushën e investimeve dhe eksporteve të përcaktuara me vendim të Qeverisë.</p> <p>5. Anëtari i Këshillit nuk mund të përfshihet në veprimtarinë e investimit strategjik që ka shqyrtuar pa kaluar pesë (5) vjet nga përfundimi i mandatit të anëtarit.</p> <p>6. AIE kryen rolin e sekretariatit për Këshillin.</p> <p>7. AIE përgatitë propozimet për planet e veprimit, raportet dhe vendimet e Këshillit për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve.</p> <p>8. Puna e Këshillit rregullohet me akt nënligjor të Qeverisë.</p>	<p>4.7. Performs other functions related to the field of investments and exports determined by the decision of the Government.</p> <p>5. The member of the Council cannot be involved in the strategic investment activity that has been reviewed without passing five (5) years from the end of the member's mandate .</p> <p>6. AIE performs the role of secretariat for the Council.</p> <p>7. AIE prepares proposals for action plans, reports and decisions of the Council for the promotion and protection of investments and exports.</p> <p>8. The work of the Council is regulated by a sub-legal act of the Government.</p>	<p>4.7. Obavlja i druge funkcije iz oblasti investicija i izvoza utvrđene odlukom Vlade.</p> <p>5. Član Saveta ne može biti uključen u stratešku investicionu aktivnost koja je preispitana bez proteka pet (5) godina od isteka mandata člana.</p> <p>6. AIE obavlja ulogu sekretarijata Saveta.</p> <p>7. AIE priprema predloge akcionih planova, izveštaja i odluka Saveta za unapređenje i zaštitu investicija i izvoza.</p> <p>8. Rad Saveta uređuje se podzakonskim aktom Vlade.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Paneli Ankimor</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Appeals Panel</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Žalbeno veće</b></p>
<p>1. Paneli Ankimor i Investimeve i Republikës së Kosovës shqyrton ankesat e investitorëve sipas nenit 47 të këtij ligji.</p> <p>2. Paneli Ankimor emërohet me vendim të Qeverisë.</p> <p>3. Paneli Ankimor ka pesë (5) anëtarë.</p>	<p>1. The Investment Appeals Panel of the Republic of Kosovo shall review the complaints of investors as defined by Article 47 of this Law.</p> <p>2. The Complaints Panel shall be appointed by a decision of the Government.</p> <p>3. The Complaints Panel shall have five (5) members.</p>	<p>1. Žalbeno veće za investicije Republike Kosovo razmatra žalbe investitora u skladu sa članom 47. ovog zakona.</p> <p>2. Žalbeno Veće se imenuje odlukom Vlade.</p> <p>3. Žalbeno veće ima pet (5) članova.</p>

<p>4. AIE kryen shërbimet e sekretarisë për Panelin Ankimor.</p> <p>5. Paneli Ankimor miraton rregullat e procedurës në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Qeveria me akt nënligjor përcakton statusin dhe kompensimin e anëtarëve të Panelit Ankimor.</p>	<p>4. AIE shall perform secretary services for the Complaints Panel.</p> <p>5. The Complaints Panel shall adopt the procedural rules in line with the applicable legislation.</p> <p>6. The Government shall, by a sub-legal act, determine the status and compensation of the Complaints Panel members.</p>	<p>4. AIE obavlja poslove sekretarijata za Žalbeno veće.</p> <p>5. Žalbeno veće usvaja poslovnik u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>6. Vlada podzakonskim aktom utvrđuje status i naknadu članova Žalbenog veća.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Detyrimi i bashkëpunimit</b></p> <p>1. Çdo autoritet publik ka detyrë të bashkëpunojë me Këshillin, AIE dhe Panelin Ankimor dhe të ndihmojë në zbatimin e këtij ligji.</p> <p>2. Dështimi i zyrtarit publik për të bashkëpunuar sipas paragrafit 1 të këtij neni përbën shkelje të rëndë të detyrës, sipas ligjit përkatës për Zyrtarë Publik.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Obligation of cooperation</b></p> <p>1. Every public authority has the duty to cooperate with the Council, AIE and the Ankimor Panel and to help in the implementation of this law.</p> <p>2. The failure of the public official to cooperate according to paragraph 1 of this article constitutes a serious breach of duty, according to the relevant law on Public Officials.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Obaveza saradnje</b></p> <p>1. Svaki javni organ je dužan da saraduje sa Savetom, AIE i Žalbenim panelom i pomaže u primeni ovog zakona.</p> <p>2. Propust javnog službenika da saraduje prema stavu 1. ovog člana predstavlja tešku povredu dužnosti, prema relevantnom zakonu o javnim službenicima.</p>
<p><b>KAPITULLI V</b> <b>INVESTIMET STRATEGJIKE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Kushtet e përgjithshme</b></p> <p>1. Investimi strategjik gëzon përparësi dhe për-krahje të posaçme sipas këtij ligji.</p>	<p><b>CHAPTER V</b> <b>STRATEGIC INVESTMENTS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>General conditions</b></p> <p>1. Strategic investment shall enjoy special advantages and support under to this Law.</p>	<p><b>POGLAVLJE V</b> <b>STRATEŠKE INVESTICIJE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Opšti uslovi</b></p> <p>1. Strateška investicija uživa posebne prednosti i podršku prema ovom zakonu.</p>

<p>2. Mund të shpallet investim strategjik projekti investues që përmbush këto kushte:</p> <p>2.1. projekti ndihmon në përmbushjen e objektivave shtetërore nga neni 14 i këtij ligji;</p> <p>2.2. projekti përkon në sektorët prioritar nga neni 15 i këtij ligji;</p> <p>2.3. propozuesi ka dëshmuar aftësinë financiare për ta zbatuar investimin;</p> <p>2.4. projekti është në pajtim me nenin 30 të këtij ligji;</p> <p>2.5. projekti i është nënshtruar verifikimit plotësues nëse kërkohet sipas kapitullit VII të këtij ligji dhe është dhënë vendim për autorizimin e investimit sipas nenit 40 të këtij ligji.</p> <p>3. Investimi strategjik duhet të arrijë vlerën se paku njëzet (20) milionë euro, përveç nëse Qeveria me akt nënligjor përcakton prag tjetër, por jo më të ulët se dhjetë (10) milionë euro. Mund të caktohen pragje të ndryshme varësisht nga:</p> <p>3.1. sektori;</p> <p>3.2. shkalla e zhvillimit të rajonit ku propozohet investimi;</p>	<p>2. Strategic investment that meets the following conditions may be declared an investment project:</p> <p>2.1. the project helps in fulfilling the national objectives referred to in Article 14 of this Law;</p> <p>2.2. the project belongs to the priority sectors referred to in Article 15 of this Law;</p> <p>2.3. the proposer has demonstrated the financial ability to implement the investment;</p> <p>2.4. the project is in accordance with Article 30 of this Law;</p> <p>2.5. the project has been subject to screening if required as defined by Chapter VII of this Law, and VII and a decision has been made to allow investment under Article 40 of this Law.</p> <p>3. The strategic investment must reach the value of twenty (20) million Euros, unless the Government sets another threshold by means of a sub-law, but not lower than ten (10) million Euros. Different thresholds may be set, depending on:</p> <p>3.1. sector;</p> <p>3.2. degree of development of the region where the investment is proposed;</p>	<p>2. Investicioni projekat koji ispunjava sledeće uslove može se proglasiti strateškom investicijom:</p> <p>2.1. projekat pomaže u ispunjavanju - državnih ciljeva iz člana 14. ovog zakona;</p> <p>2.2. projekat spada u prioritetne sektore iz člana 15. ovog zakona</p> <p>2.3. predlagač je dokazao finansijsku sposobnost za realizaciju investicije</p> <p>2.4. projekat je u skladu sa članom 30. ovog zakona;</p> <p>2.5. projekat je podvrgnut dodatnoj proveru ako je bilo potrebno prema poglavlju VII ovog zakona i doneta je odluka da se odobri investicija u skladu sa članom 40. ovog zakona.</p> <p>3. Strateška investicija mora dostići vrednost od najmanje dvadeset (20) miliona eura, osim ako Vlada podzakonskim aktom ne odredi drugi prag, ali ne manji od deset (10) miliona eura. Mogu se postaviti različiti pragovi u zavisnosti od:</p> <p>3.1. sektora;</p> <p>3.2. stepena razvijenosti regiona u kojem - se predlaže investicija;</p>
---	--	---

<p>3.3. investimi në vis urban apo vis rural;</p> <p>3.4. mundësia e punësimit ose aftësimit të të rinjve, të grave ose pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë;</p> <p>3.5. mundësia e përmbushjes së ndonjë objektivi tjetër shtetëror nga neni 14 i këtij ligji.</p> <p>4. I jepet përparësi në përzgjedhje projektit që ka vlerë më të madhe dhe ndihmon më shumë në përmbushjen e objektivave shtetërore nga neni 14 i këtij ligji, sidomos objektivat e punësimit, rritjes së prodhimit dhe exportit, zhvillimit rajonal dhe qëndrueshmërisë mjedisore.</p>	<p>3.3. investment in urban or rural areas;</p> <p>3.4. possibility of employment or training of young people, women or members of non-majority communities;</p> <p>3.5. the possibility of fulfilling another national objective from Article 14 of this Law.</p> <p>4. Priority in selection shall be given to the project that has greater value and helps more in fulfilling the state objectives from Article 14 of this Law, especially the objectives of employment, increasing manufacturing and exports, regional development and environmental sustainability.</p>	<p>3.3. investicije u urbana ili ruralna područja;</p> <p>3.4. mogućnost zapošljavanja ili obuke mladih, žena ili pripadnika nevećinskih zajednica;</p> <p>3.5. mogućnost ispunjenja bilo kojeg drugog državnog cilja iz člana 14. ovog zakona.</p> <p>4. Pri izboru se daje prednost projektu koji ima veću vrednost i više pomaže u ispunjavanju državnih ciljeva iz člana 14. ovog zakona, posebno ciljevima zapošljavanja, rastu proizvodnje i izvoza, regionalnog razvoja i ekološke održivosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Kujdesi ndaj investitorit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Investor care</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Pažnja prema investitoru</b></p>
<p>1. AIE jep këto shërbime të kujdesit ndaj investitorit:</p> <p>1.1. lehtësime për përgatitjen e kërkesës dhe ndjekjen e procedurës administrative për pajisje me leje, licencë, pëlqim, autorizim ose akt të ngjashëm të organit administrativ;</p> <p>1.2. përkrahje për qasje në infrastrukturë themelore;</p>	<p>1. AIE shall provide the following investor care services:</p> <p>1.1. facilitation in preparing the request and following the administrative procedure for equipment with a permit, license, consent, authorization or similar act of the administrative body;</p> <p>1.2. support for access to basic infrastructure;</p>	<p>1. AIE pruža sledeće usluge brige za investitore :</p> <p>1.1. olakšice za pripremu zahteva i sprovođenje upravnog postupka za opremanje sa dozvolom, licencom, saglasnosti, ovlašćenjem ili sličnim aktom organa uprave;</p> <p>1.2. podrška za pristup osnovnoj infrastrukturi;</p>

<p>1.3. përkrahje për qasje në parqe industriale dhe teknologjike;</p> <p>1.4. shërbime të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me akt nënligjor të Qeverisë</p> <p>2. U jepet përparësi në shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni me rend:</p> <p>2.1. investimit strategjik;</p> <p>2.2. investimit që ndihmon më shumë në përbushjen e objektivave shtetërorë nga neni 14 i këtij ligji;</p> <p>2.3. investimit në sektor prioritar nga neni 14 i këtij ligji.</p> <p>3. Qeveria me akt nënligjor përcakton kriteret dhe procedurat e shërbimeve të kujdesit ndaj investitorit.</p>	<p>1.3. support for access to industrial and technology parks;</p> <p>1.4. other services defined by a sub-legal act of the Government.</p> <p>2. Priority shall be given to services referred to in paragraph 1 of this Article in the following order:</p> <p>2.1. strategic investment;</p> <p>2.2. investment that helps more in achieving the national objectives referred to in Article 14 of this Law;</p> <p>2.3. investment in the priority sectors referred to in Article 14 of this Law.</p> <p>3. The Government shall, by a sub-legal act, determine the criteria and procedures of care services for the investor.</p>	<p>1.3. podrška za pristup industrijskim i tehnološkim parkovima;</p> <p>1.4. druge usluge utvrđene podzakonskim aktom Vlade.</p> <p>2. Prioritet se daje uslugama iz tabele 1. ovog člana po redosledu:</p> <p>2.1. strateške investicije ;</p> <p>2.2. investicije koje više pomaže u ispunjavanju državnih ciljeva iz člana 14. ovog zakona;</p> <p>2.3. investicije u prioritetni sektor iz člana 14. ovog zakona.</p> <p>3. Vlada podzakonskim aktom utvrđuje kriterijume i procedure pružanja usluga brige o investitorima .</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Regjistri dhe njoftimet për investimet</b></p> <p>1. AIE mban dhe publikon regjistrin e investimeve me këtë përmbajtje:</p> <p>1.1. lista e investitorëve të huaj dhe sipërmarrjeve eksportuese;</p> <p>1.2. lista e investimeve strategjike;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Register and announcements of investments</b></p> <p>1. AIE shall maintain and publish the investment register with the following content:</p> <p>1.1. list of foreign investors and exporting companies;</p> <p>1.2. list of strategic investments;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Registar i obaveštenja za investicije</b></p> <p>1. AIE vodi i objavljuje registar investicija sledećeg sadržaja:</p> <p>1.1. lista stranih investitora i izvoznih kompanija;</p> <p>1.2. lista strateških investicija;</p>



<p>1.3. lista e projekteve të përgatitura për investime strategjike sipas nenit 24 të këtij ligji;</p> <p>1.4. lista e pronave të paluajtshme publike që mund të shfrytëzohen sipas nenit 28 të këtij ligji;</p> <p>1.5. lista e parqeve industriale, parqeve teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit;</p> <p>1.6. lista e lejeve dhe licencave dhe organeve kompetente për dhënien e tyre, në përputhje me ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.</p> <p>2. AIE përgatit dhe publikon njoftime të nevojshme për investimet, duke përfshirë sidomos:</p> <p>2.1. objektivat shtetërorë nga neni 14 i këtij ligji;</p> <p>2.2. sektorët prioritar nga neni 15 i këtij ligji;</p> <p>2.3. lehtësirat nga neni 16 i këtij ligji;</p> <p>2.4. shërbimet e kujdesit ndaj investitorit nga neni 25 i këtij ligji;</p> <p>2.5. informatat e nevojshme për investimet strategjike;</p>	<p>1.3. list of projects prepared for strategic investments according to Article 24 of this Law;</p> <p>1.4. list of public immovable properties that can be used according to Article 28 of this Law;</p> <p>1.5. list of industrial parks, technology parks and business incubators;</p> <p>1.6. list of permits and licenses and the competent bodies for their issuance, in accordance with the relevant law on the system of permits and licenses.</p> <p>2. KIAA shall prepare and publish the necessary announcements for investments, including in particular:</p> <p>2.1. national objectives from Article 14 of this Law;</p> <p>2.2. priority sectors from Article 15 of this Law;</p> <p>2.3. facilities from Article 16 of this Law;</p> <p>2.4. investor care services from Article 25 of this Law;</p> <p>2.5. information needed for strategic investments;</p>	<p>1.3. spisak projekata pripremljenih za -strateške investicije u skladu sa članom 24. ovog zakona;</p> <p>1.4. spisak državnih javnih nepokretnosti koje se mogu koristiti u skladu sa članom 28. ovog zakona;</p> <p>1.5. spisak industrijskih parkova, tehnoloških parkova i biznis inkubatora;</p> <p>1.6. spisak dozvola i licenci i nadležni organ za njihovo izdavanje, u skladu sa relevantnim zakonom o sistemu dozvola i licenci.</p> <p>2. APIK priprema i objavljuje detaljna saopštenja o investicijama, uključujući posebno:</p> <p>2.1. državne ciljeve iz člana 14. ovog zakona;</p> <p>2.2. prioritetne sektore iz člana 15. ovog zakona;</p> <p>2.3. objekti iz člana 16. ovog zakona;</p> <p>2.4. usluge brige o investitorima iz člana 25. ovog zakona;</p> <p>2.5. potrebne informacije za strateške investicije;</p>
--	---	---

<p>2.6. informatat e nevojshme për qasjen në parqe industriale, parqet teknologjike dhe inkubatorët te biznesit;</p> <p>2.7. informata mbi procedurat administrative për pajisje me leje, licencë, pëlqim, autorizim ose akt të ngjashëm të organit administrativ lidhur me investimet.</p> <p>3. Qeveria me akt nënligjor përcakton mënyrën e mbajtjes së regjistrit dhe njoftimeve.</p>	<p>2.6. required information for access to industrial parks, technology parks and business incubators;</p> <p>2.7. information on administrative procedures for obtaining a permit, license, consent, authorization or similar act of the administrative body related to investments.</p> <p>3. The Government shall, by a sub-legal act, determine the manner of keeping the register and announcements.</p>	<p>2.6. potrebne informacije za pristup industrijskim parkovima, tehnološkim i biznis inkubatorima;</p> <p>2.7. podatke o upravnim postupcima za dobijanje dozvole, licence, saglasnosti, ovlašćenja ili slični akt organa uprave koji se odnosi na investicije.</p> <p>3. Vlada podzakonskim aktom utvrđuje način vođenja registra i obaveštenja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Shërbimet ndaj investitorit strategjik</b></p> <p>1. U jepet përparësi e lartë procedurave administrative lidhur me përgatitjen, shqyrtimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e investimeve strategjike.</p> <p>2. AIE i jep investitorit këto shërbime lidhur me investimin strategjik:</p> <p>2.1. përkrahje të individualizuar përmes zyrtarit përgjegjës për investimin strategjik;</p> <p>2.2. lehtësim me përparësi në përgatitjen e kërkesës dhe ndjekjen e procedurës administrative për pajisje me leje, licencë, pëlqim, autorizim ose akt të ngjashëm të organit administrativ;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Services to strategic investors</b></p> <p>1. High priority shall be given to administrative procedures related to the preparation, review, implementation and supervision of strategic investments.</p> <p>2. AIE shall provide the following services to the investor regarding strategic investments:</p> <p>2.1. individualized support through the officer responsible for the strategic investment;</p> <p>2.2. facilitation in preparing the request and following the administrative procedure for equipment with a permit, license, consent, authorization or similar act of the administrative body;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Usluge strateškim investitorima</b></p> <p>1. Visoki prioritet se daje administrativnim procedurama koje se odnose na pripremu, razmatranje, implementaciju i nadzor strateških investicija.</p> <p>2. AIE pruža investitoru sledeće usluge vezane za strateške investicije:</p> <p>2.1. individualizovana podrška preko službenika odgovornog za strateške investicije;</p> <p>2.2. olakšice uz prednosti u pripremi zahteva i praćenju upravnog postupka za opremanje sa dozvolom, licencom, dobijanje saglasnosti, ovlašćenja ili sličnih akata organa uprave;</p>

<p>2.3. përkrahje me përparësi për qasje në parqe industriale;</p> <p>2.4. vënie në dispozicion të katalogut të pronave të paluajtshme në pronësi publike për zbatimin e investimit strategjik;</p> <p>2.5. shërbime të tjera të përcaktuara me akt nënligjor të Qeverisë.</p> <p>3. AIE përcjell kërkesën nga nënparagrafi 2.2 i këtij neni te organi kompetent brenda pesë (5) ditëve nga dorëzimi i kërkesës së plotë.</p> <p>4. Organi administrativ shqyrton kërkesën nga nënparagrafi 2.2 i këtij neni brenda gjysmës së afatit të përcaktuar me ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative ose me legjislacionin e posaçëm. Kur kërkesa është e ndërlikuar, afati mund të zgjatet vetëm një herë sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>5. Investitori duhet të parashtrojë të dhëna dhe dokumente të plota, të sakta dhe sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Shfrytëzimi i pronës</b></p> <p>1. Prona e paluajtshme publike jepet në shfrytëzim për investimin strategjik:</p>	<p>2.3. priority support for access to industrial parks;</p> <p>2.4. availability of immovable state property for the implementation of the strategic investment;</p> <p>2.5. other services defined by a sub-legal act of the Government.</p> <p>3. KIAA shall forward the request from sub-paragraph 2.2 of this Article to the competent body within five (5) days from the submission of the complete request.</p> <p>4. The administrative body shall review the request referred to in sub-paragraph 2.2 of this Article within half of the term set by the relevant law concerning the general administrative procedure or by the special legislation. When the request is complex, the deadline may be extended only once according to the legislation in force.</p> <p>5. The investor shall submit data and documents, accurate, as required by applicable law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Use of property</b></p> <p>1. Immovable state public property shall be leased for strategic investment:</p>	<p>2.3. prioritetna podrška za pristup industrijskim parkovima;</p> <p>2.4. stavljanje državnih nepokretnosti na raspolaganje za realizaciju strateške investicije;</p> <p>2.5. druge usluge utvrđene pravnim aktom Vlade.</p> <p>3. APIK prosleđuje zahtev iz tačke 2.2 ovog člana nadležnom organu u roku od pet (5) dana od podnošenja kompletnog zahteva.</p> <p>4. Organ uprave razmatra zahtev iz tačke 2.2 ovog člana u roku od polovine roka određenog relevantnim zakonom za opšti upravni postupak ili posebnim zakonom. Kada je zahtev komplikovan, rok se može produžiti samo jednom u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>5. Investitor je dužan da dostavi potpune i tačne podatke kao i dokumente propisane - važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Korišćenje imovine</b></p> <p>1. Državna javna nepokretna imovina daje se na korišćenje za strateške investicije:</p>
---	---	--

<p>1.1. pas miratimit të Kuvendit të Republikës dhe në përputhje me ligjin përkatës për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nëse prona është në pronësi shoqërore;</p> <p>1.2. pas miratimit të Kuvendit të Republikës, nëse prona është në pronësi të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. pas miratimit të kuvendit të komunës përkatëse, nëse prona është në pronësi komunale;</p> <p>1.4. në përputhje me ligjin përkatës për ndërmarrjet publike, nëse prona është në pronësi të ndërmarrjes publike.</p> <p>2. Prona e paluajtshme publike mund të jepet në shfrytëzim për kohëzgjatjen e investimit strategjik deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet, sipas ligjit përkatës për dhënien në shfrytëzim të pronës.</p> <p>3. Qeveria me akt nënligjor përcakton mënyrën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike për investim strategjik, në përputhje me rregullimin hapësinor dhe urbanistik dhe legjislacionin e zbatueshëm për ndihmën shtetërore, pronën publike, të drejtat pronësore, marrëdhëniet e detyrimeve, partneritetin publiko-privat dhe prokurimin publik.</p>	<p>1.1. after the approval of the Assembly of the Republic and in accordance with the relevant law on expropriation of immovable property, if it is socially-owned;</p> <p>1.2. after the approval of the Assembly of the Republic of Kosovo, if the property is owned by the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. after the approval of the relevant municipal assembly, if the property is a municipal property;</p> <p>1.4. in accordance with the relevant law on public enterprises, if the property is owned by a public enterprise.</p> <p>2. Immovable state property may be leased for the duration of the strategic investment for up to ninety-nine (99) years, according to the relevant law on allocation for use of property.</p> <p>3. The Government shall, by sub-legal act, determine the manner of granting the use of immovable state property for strategic investment, in accordance with the spatial and urban planning regulation and the applicable legislation on state aid, state and public property, property rights, obligational relationships, public-private partnership and public procurement.</p>	<p>1.1. nakon odobrenja Skupštine Republike i u skladu sa odgovarajućim zakonom o eksproprijaciji nepokretnosti, ako je imovina u društvenoj svojini;</p> <p>1.2. nakon odobrenja Skupštine Republike , ako je imovina u vlasništvu Republike Kosovo;</p> <p>1.3. nakon odobrenja relevantne skupštine opštine, ako je imovina u vlasništvu opštine;</p> <p>1.4. u skladu sa relevantnim zakonom o - javnim preduzećima, ako je imovina u vlasništvu javnog preduzeća.</p> <p>2. Državna nepokretna imovina može se dati na korišćenje tokom trajanja strateške investicije do devedeset devet (99) godina, u skladu sa relevantnim zakonom o davanju na korištenje imovine.</p> <p>3. Vlada podzakonskim aktom utvrđuje način davanja na korišćenje državne nepokretnosti za strateške investicije, u skladu sa prostornim i urbanističkim uređenjem i važećim propisima o državnoj pomoći, državnoj i javnoj svojini, imovinskim pravima, obligacionim odnosima, javno-privatno partnerstvo i javne nabavke.</p>
--	--	--

<p>4. Vendimi për revokimin e investimit strategjik ndërpret të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike.</p>	<p>4. The decision for revocation of the strategic investment shall terminate the right to use immovable state property.</p>	<p>4. Odlukom o opozivu strateške investicije prestaje pravo korišćenja državne nekretnine.</p>
<p><b>KAPITULLI VI PROCEDURA</b></p>	<p><b>CHAPTER VI PROCEDURE</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VI POSTUPAK</b></p>
<p><b>Neni 29 Propozuesi dhe zbatuesi i Projektit investues</b></p>	<p><b>Article 29 Proposer and implementer of the investment project</b></p>	<p><b>Član 29 Predlagač i realizator investicionog projekta</b></p>
<p>1. Mund të shpallet investim strategjik, projekti investues që përgatitet, propozohet ose zbatohet nga:</p>	<p>1. The investment project that is prepared, proposed or implemented by the following may be announced a strategic investment:</p>	<p>1. Može se proglasiti strateškom investicijom, onaj investicioni projekat koji priprema ili primenjuje:</p>
<p>1.1. shoqëria tregtare në pronësi private;</p>	<p>1.1. privately owned trading company;</p>	<p>1.1. privatna komercijalna kompanija;</p>
<p>1.2. partneriteti publiko-privat;</p>	<p>1.2. public-private partnership;</p>	<p>1.2. javno-privatno partnerstvo;</p>
<p>1.3. Institucioni publik;</p>	<p>1.3. public institution;</p>	<p>1.3. javna institucija;</p>
<p>1.4. ndërmarrja publike ose shoqërore;</p>	<p>1.4. public or social enterprise;</p>	<p>1.4. javno ili društveno preduzeće;</p>
<p>1.5. bashkëpunimi kontraktues i autoritetit publik dhe ndërmarrjes publike ose shoqërore;</p>	<p>1.5. contracting cooperation of public authority and public or social enterprise;</p>	<p>1.5. saradnja pri ugovaranju organa javne vlasti i javnog ili društvenog preduzeća;</p>
<p>1.6. organizata joqeveritare;</p>	<p>1.6. non-governmental organization;</p>	<p>1.6. nevladine organizacije;</p>
<p>1.7. entiteti sipas marrëveshjes ndërkombëtare; ose</p>	<p>1.7. entity under an international agreement; or</p>	<p>1.7. subjekt prema međunarodnom sporazumu; ili</p>

<p>1.8. entiteti në bashkëpunim me Bashkimin Evropian ose me një institucion financiar ndërkombëtar.</p> <p>2. Pala nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jetë shtetas i Kosovës ose shtetas i huaj.</p> <p>3. AIE vlerëson nëse projekti i përgatitur sipas paragrafit 1 të këtij neni a është në përputhje me ligjin. Këshilli shqyrton dhe merr vendim lidhur me projektin pas rekomandimit të AIE.</p> <p>4. Qeveria me akt nënligjor përcakton:</p> <p>4.1. procedurën e shqyrtimit të projekteve të përgatitura për investime strategjike;</p> <p>4.2. mbështetjen financiare të projekteve të përgatitura për investime strategjike.</p>	<p>1.8. entity in cooperation with the European Union or another international financial institution.</p> <p>2. The party from paragraph 1 of this Article may be a national or foreign person.</p> <p>3. AIE shall assess whether the project prepared according to paragraph 1 of this article is in accordance with the law. The Council shall examine and take a decision regarding the project after the recommendation of AIE.</p> <p>4. The Government shall, by a sub-legal act, determine:</p> <p>4.1. the procedure for reviewing projects prepared for strategic investments;</p> <p>4.2. financial support of projects prepared for strategic investments.</p>	<p>1.8. subjekt u saradnji sa Evropskom unijom ili međunarodnom finansijskom institucijom.</p> <p>2. Stranka iz stava 1. ovog člana može biti domaće ili strano lice.</p> <p>3. APIK ocenjuje da li je projekat pripremljen prema stavu 1. ovog člana u skladu sa zakonom. Savet razmatra i donosi odluku o projektu nakon preporuke AIE.</p> <p>4. Vlada podzakonskim aktom definiše:</p> <p>4.1. postupak razmatranja projekata pripremljenih za strateške investicije;</p> <p>4.2. finansijsku podršku projektima pripremljenim za strateške investicije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Propozimi i investimit strategjik</b></p> <p>1. Propozimi i investimit strategjik i parashtrahet për shqyrtim AIE.</p> <p>2. Në formularin e propozimit të investimit strategjik, propozuesi saktëson nëse kërkon shqyrtim paraprak apo shqyrtim përfundimtar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Strategic investment proposal</b></p> <p>1. The strategic investment proposal shall be submitted to AIE.</p> <p>2. In the strategic investment proposal form, the proposer shall specify if they request preliminary or final review.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Predlog strateške investicije</b></p> <p>1. Predlog strateške investicije podnosi se AIE- u na razmatranje.</p> <p>2. U obrascu strateškog investicionog predloga predlagač precizira da li je potrebno preliminarno ili završno razmatranje.</p>

